



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëhoq/Prudato Received/Delivered	10.08.2022	viti god. year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIPRI	4642/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.574/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.574/2022 të datës 27.06.2022, të parashtruar nga ankuesja

nga kundër organit të punësimit Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 09.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.574/2022 e datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Anulohet Akti njoftues me numër protokollit 06/07-727-01-22 i datës 06.06.2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të vazhdojë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë sipas Konkursit me numër reference RN0008862 për pozitën “Zyrtar për Arkiv 2” nga faza e verifikimit paraprak.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën III të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 27.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3734/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokollit 06/07-727-01-22 të datës 06.06.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në



Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës për anulimin e Konkursit me numër reference RN0008862 për pozitën "Zyrtar për Arkiv 2", me pretendimin për shkelje të procedurave dhe heshtjes administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Presidencën e Republikës së Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 15.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3734/2022 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN0008862; Njoftimin me numër protokollit 06/07-727-01-22 të datës 06.06.2022; Emalin zyrtar të datës 27.05.2022 nga A.I drejtuar M.H; Emalin zyrtar të datës 15.06.2022 nga A.I drejtuar M.H; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3852/2022 të datës 01.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4143/2022 të datës 15.07.2022 Emalin zyrtar të datës 10.06.2022 te A.I drejtuar M.H; Emalin zyrtar të datës 06.06.2022 të A.I drejtuar M.H; Emalin zyrtar të datës 27.05.2022 te A.I drejtuar M.H; Aplikacionin e datës 10.05.2022 të kandidatës A.I; Diplomën me Nr.2160 të datës 06.08.2012; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në Seminar "Ruajtja dhe Mbrojtja e dokumenteve zyrtare" prej datës 01-05.06.2015; Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnim "Korniza e përbashkët e vete-vlerësimit" (KPV) të datës 12-13.10.2015; Vërtetimin me numër 02.112-14440/20 të datës 30.06.2020; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil për vitin 2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për vitin 2020; Vërtetimin me numër 02.112-1780/2022 të datës 17.01.2022; Vërtetimin me numër 02.112-11431/22 të datës 12.03.2022; Dëshminë lidhur me patentën e shoferit të ankueses; Emalin zyrtar të datës 02.08.2022 me numër të protokollit 4476/2022 lidhur me provat shtesë; Emalin zyrtare të datës 02.08.2022 të I.M drejtuar M.H;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses

SEPSE:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh së Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës më datë 22.04.2022 ka shpallur Njoftimin për Konkursin me numër reference RN0008862 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Arkiv 2" e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja si kandidate e vetme. Menaxherja e Personelit në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës më datë 06.07.2022 ka nxjerrë Njoftimin me numër protokollit 06/07-727-01-22 me të cilin ka anuluar konkursin në fjalë më arsyetim se nuk janë plotësuar kushtet dhe kriteret e kërkuara sipas këtij konkursi.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës respektivisht përkitazi me përcaktimin e legjitimitetit të ankueses si palë në procedurë, ju referua nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin theksohet se: *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar*

procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike, ndërlidhur me këtë neni 24 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative... dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se ankuesja ka legjitimitetin e palës në këtë procedurë sepse organi i punësimit nuk ka nxjerr akt administrativ në procedurën të verifikimit paraprak, e që me këtë do i mundësohej palës ankuese të drejtën e ankesës së brendshme ashtu siç përcaktohet me nenin 45 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës me rastin e anulimit të Konkursit me numër reference RN00008862 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Arkiv 2", ka bërë shkelje të procedurave pasi që organi i punësimit nuk ka përfunduar verifikimin paraprak dhe nuk e ka informuar ankuesen lidhur me plotësimin apo mos plotësimin e kushteve sipas konkursit dhe së Zyra e Presidentit të Kosovës ka bërë heshtje administrative ndaj kërkesave të ankueses të datës 27.05.2022, 03.06.2022, 10.06.2022 dhe 15.06.2022.

Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë e duke u bazuar në nenin 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton së lëvizja brenda kategorisë është procedurë konkurruese e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil, e të cilët plotësojnë edhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. Mbi këtë bazë ligjor, Zyra e Presidentit të Kosovës ka shpallur Konkursin me numër reference RN00008862 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Arkiv 2" sipas të cilit si kërkesa të veçanta janë përcaktuar: *të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën apliko; të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fund, ndërsa si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimi i kërkuar: Shkollimi i mesëm, preferohet drejtimi juridik, ekonomik, administratë. Përvoja e punës: se paku dy (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative dhe kërkohet patentë shoferi kategoria B me përvojë tri (3) vjeçare në vozitje.***

Kolegji lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore ju referuar nenit 44 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve, si dhe nenit 45 të kësaj Rregullore ku theksohet se: Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3..... 4.Kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire renditen në një listë të shkurtër në rendin alfabetik. Lista e shkurtër shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. 5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda*

kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Andaj, në kuptim të kësaj baze ligjore si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Zyra e Presidentit të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat si me lartë, për shkak se lidhur me Konkursin e shpallur me numër reference RN00008862 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Arkiv 2", Menaxherja e Personelit si njësi përgjegjëse nuk ka përgatit listën e aplikuesëve e që në këtë rast ka qenë vetëm ankuesja, si dhe nuk ka nxjerrë asnjë vendim lidhur mosplotësimin e kushteve të konkursit nga ana e ankueses, por, me aktin njoftues me numër protokoll 06/07-727-01-22 ka anuluar konkursin në fjalë më arsyetim se nuk janë plotësuar kushtet dhe kriteret e kërkuara sipas konkursit të shpallur dhe se me asnjë provë nuk dëshmohet së ankuesja si kandidatë konkurruese të jetë njoftuar lidhur me aplikimin, plotësimin apo mosplotësimin e kushteve si dhe ecurinë e këtij procesi, kështu që mos ndërmarrje e këtyre veprime ligjore procedurale janë në kundërshtim të plotë edhe me parimet bazë të procedurës së përgjithshme administrative të përcaktuara me nenin 11 dhe 13 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson së anulimi i Konkursit me numër reference RN00008862 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Arkiv 2" është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që akti njoftues me numër protokoll 06/07-727-01-22 i datës 06.06.2022 për anulimin e konkursit në fjalë konsiderohet akt i paligjshme sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj, mbi këto arsye obligohet Menaxherja e Personelit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës që të ndërmerr të gjitha veprimet siç përcaktohet në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi.

Theksuar si me lartë, Kolegji bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.574/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procësbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses*
- *Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*

